

PROF. DR. LEDIA DUSHKU

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
ledia_dushku@yahoo.com

**NDËRTIMI I SHTETIT NË KOHË TË PASIGURTA:
PROJEKTET FINANCIARE, KAPITALI I HUAJ
DHE SOVRANITETI NË SHQIPËRINË E VITEVE
1913-1918**

Abstrakt:

Artikulli ka në fokus përpjekjet për ndërtimin e një shteti funksional në Shqipërinë e pas pavarësisë, në një kontekst të pasigurt politik dhe ekonomik. Në qendër të analizës është ngritja e sistemit financiar kombëtar, fillimet e të cilit i gjejmë te projekti i Bankës Kombëtare Shqiptare, i konceptuar nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës si një hap drejt konsolidimit institucional dhe pavarësisë financiare. Megjithatë, marrëveshja koncesionare e vitit 1913 e ktheu këtë nismë në një mjet të kontrollit austro-italian, duke e lënë palën shqiptare në pozitë periferike. Gjatë Luftës së Parë Botërore, fragmentimi territorial dhe monetar e pengoi ndërtimin e një tregu financiar kombëtar dhe e shndërroi monedhën në instrument të dominimit politik. Një përjashtim i kufizuar ishin bonot e Korçës (1917), të mbikëqyrura nga autoritetet franceze, të cilat mbartnin funksion simbolik në afirmimin e identitetit shtetëror shqiptar. Duke u mbështetur në qasjet teorike të shtetformimit, varësisë strukturore dhe imperializmit strukturor, artikulli ndriçon tensionin mes projekteve të modernizimit dhe kufizimeve të vendosura nga arkitektura ndërkombëtare e pushtetit. Përmes analizës së dokumenteve arkivore dhe literaturës historike, artikulli argumenton se rasti shqiptar përfaqëson një shembull paradigmatic të sfidave të shtetformimit në periferinë globale, ku ndërtimi i institucioneve kombëtare varej nga balanca e Fuqive të Mëdha dhe konteksti gjeopolitik, rrjedhojë e Luftës së Parë Botërore.

Fjalë kyç:

Shtetformim, Banka Kombëtare Shqiptare, varësi strukturore, sovranitet, modernizim periferik, Lufta e Parë Botërore.

Hyrje: Korniza teorike për analizën e institucioneve financiare në një shtet periferik

Vitet 1913-1918 përbëjnë fazën fillestare të shtetësisë për shqiptarët, proces gjatë të cilit përparësi mbetej ngritja e institucioneve kombëtare, përfshirë edhe ato financiare, si elemente kyç për afirmimin e sovranitetit ekonomik. Në këtë periudhë të brishtë, ku kufijtë shtetërorë, legjitimiteti dhe kapacitetet shtetërore ishin ende të kontestuara, projektet financiare fituan një rëndësi të veçantë edhe si tregues të aftësisë për vetëqeverisje. Pas Shpalljes së Pavarësisë më 28 nëntor 1912, krijimi i Bankës Kombëtare Shqiptare, si projekti i parë madhor financiar i shtetit të ri, u konceptua nga Qeveria e Përkohshme shqiptare si një instrument thelbësor për ushtrimin e sovranitetit ekonomik dhe ndërtimin e infrastrukturës së një shteti modern. Institucioni mori jetë në tetor 1913, në një kontekst politik të ndërlikuar, ku Shqipëria, si një shtet periferik, i vogël dhe ende i pastabilizuar, ndodhej nën trysinë e interesave të Fuqive të Mëdha dhe në varësi të tyre për ekspertizë dhe kapital. Ndërthurja e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm përcaktoi fatin e sistemit financiar në vitet e para të pavarësisë, duke krijuar një model të hershëm të varësisë strukturore, ku ndërtimi institucional do të varej nga mbështetja e jashtme.

Në rrethanat kur krijimi i Bankës Kombëtare nuk ishte vetëm një çështje teknike apo financiare, artikulli analizon fillimet e sistemit bankar shqiptar si pjesë të përpjekjeve për ndërtimin e strukturave qendrore shtetërore, duke e vendosur këtë proces në kornizën e varësisë ekonomike, modernizimit institucional dhe konsolidimit të autoritetit shtetëror. Nga ana tjetër, kombinimi i metodës narrative historike me qasje teorike komplementare ndërdisiplinore, ofron një kornizë të plotë konceptuale për të kuptuar në thellësi proceset historike, si dhe ndërveprimin e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm me ndikim në formësimin, zhvillimin apo dështimin e institucioneve financiare shqiptare. Kjo përbën risinë qendrore të këtij artikulli, i cili, përmes kësaj ndërthurjeje, mbështetur në një informacion të përditësuar arkivor dhe bibliografik, ofron një lexim të ri të procesit të shtetformimit në Shqipëri. Duke e shtrirë analizën në periudhën e Luftës së Parë Botërore dhe duke e vendosur atë në një kornizë krahasuese me zhvillimet pasuese, artikulli

ndriçon jo vetëm strukturat e brishta të institucionalizimit financiar, por edhe mekanizmat e vazhdueshëm të varësisë në kontekstin e periferisë globale.

Një prej thjerrave kyçe të kësaj analize është ajo që në literaturën bashkëkohore njihet si teoria e shtetformimit (*State-Building Theory*). Ndër autorët më të rëndësishëm për këtë qasje është sociologu dhe historiani amerikan Charles Tilly, i cili, në analizën e tij mbi formimin e shteteve europiane, argumenton se ndërtimi i institucioneve qendrore administrative dhe financiare është thelbësor për konsolidimin e autoritetit shtetëror dhe funksionimin e qëndrueshëm të një shteti. Sipas kësaj logjike, ndërtimi institucional kërkon një qeveri të fortë dhe stabilitet politik, ndërsa shtetet e sapokrijuara përballen me sfida në zhvillimin e kapaciteteve për të imponuar politika publike, për të mbledhur të ardhura dhe për të garantuar një rend të brendshëm financiar.¹

Në kontekstin shqiptar, pas Shpalljes së Pavarësisë dhe shkëputjes nga Perandoria Osmane, themelimi i Bankës Kombëtare u konsiderua nga kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemal Vlora, si një “pavarësi e dytë”.² Kontrolli mbi institucionet financiare kyçe përbënte një tregues të qartë se vendi kishte hyrë në rrugën e sovranitetit real dhe modernizimit administrativ. Në të kundërt, paaftësia për të ngritur një sistem të tillë nënkuptonte dobësi strukturore, ekspozim ndaj ndërhyrjeve dhe varësi nga aktorë të jashtëm. Për sa më sipër, analiza në këtë artikull e vendos theksin te tensioni mes ndërtimit të strukturave kombëtare dhe dominimit të jashtëm që karakterizoi fazën e parë të konsolidimit shtetëror në një kontekst periferik, siç ishte Shqipëria. Perspektiva teorike mbi ndërtimin e shtetit ndihmon në vlerësimin e përpjekjeve të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe të pasardhëseve të saj, të cilat, megjithëse të dobëta dhe të pastabilizuara, synuan ngritjen e institucioneve financiare si shtylla të sovranitetit. Në këtë kuadër, analiza përqendrohet në pyetjen thelbësore: A arriti Shqipëria në vitet 1913-1918 të ndërtojë infrastrukturën

¹ Charles Tilly, *Coercion, Capital, and European States, AD 990-1990* (Cambridge, Mass.: Basil Blackwell, 1990), 84-91; *Reflection on the History of the European State-Making, The Formation of National States in Western Europe*, edited by Charles Tilly, First Edition (Princeton: Princeton University Press, 1975), 3-83.

² “Çështja e qeverimit të Shqipëris dhe çështja e bankës”, *Përlindja e Shqipniës*, Vlonë, 5 nëntor 1913. Fjala e kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, Ismail Qemali, mbajtur në mitingun e Vlorës, 21 tetor 1913.

institucionale dhe projektet financiare të nevojshme për të funksionuar si një shtet sovran dhe modern?

Teoria e varësisë (*Dependency Theory*) ofron një kornizë analitike për të shqyrtuar marrëdhëniet asimetrike midis Shqipërisë së vogël e të brishtë dhe Fuqive të Mëdha, veçanërisht Austro-Hungarisë dhe Italisë. Në konceptimin klasik të kësaj teorie, siç është artikuluar nga ekonomisti Raúl Prebisch dhe më pas zgjeruar nga sociologu André Gunder Frank, vendet periferike përballen me vështirësi strukturore për të zhvilluar kapacitete të brendshme pa mbështetjen e kapitalit dhe teknologjisë së vendeve qendrore / Fuqive të Mëdha.³ Në rrethanat kur kjo mbështetje jepet me kushte të disfavorshme, ajo gjeneron varësi afatgjatë jo vetëm në planin ekonomik, por edhe në atë politik dhe institucional.

Rasti i Shqipërisë përbën një ilustrim të këtij modeli. Pas shkëputjes nga Perandoria Osmane vendi ishte i pazhvilluar, pa një sistem monetar unik dhe struktura financiare funksionale. Në këto rrethana, themelimi i një banke kombëtare kërkonte mbështetje të jashtme, si në formën e kapitalit ashtu edhe të ekspertizës. Kjo varësi, siç do të argumentohet më tej në këtë artikull, e transformoi ndihmën financiare në një instrument kontrolli, përmes të cilit projekti institucional i bankës u përshtat me interesat gjeopolitikë dhe ekonomikë të Fuqive të Mëdha, çka pasqyron qartazi marrëdhëniet e pabarabarta dhe nënshtrimin ekonomik.

Teoria e imperializmit strukturor (*Structural Theory of Imperialism*), e formuluar nga sociologu norvegjez Johan Galtung, ofron një kornizë analitike plotësuese ndaj teorisë së varësisë, duke ndërtuar një model më kompleks të marrëdhënieve hierarkike ndërkombëtare. Sipas kësaj teorie, sistemi global përbëhet nga tri nivele: qendra (core), periferia (periphery) dhe një “qendër brenda periferisë” (center within the periphery), e përfaqësuar nga elitat vendëse që ndërmjetësojnë nevojat e brendshme me interesat e aktorëve të jashtëm.⁴ Në këtë perspektivë, Shqipëria përfaqësonte një periferi tipike, e cila ishte objekt i ndërhyrjeve të dy poleve konkurruese të Qendrës: Austro-Hungarisë dhe Italisë.

³ Raúl Prebisch, *The Economic Development of Latin America and Its Principal Problems* (United Nations: Economic Commission for Latin America (ECLA), 1950), 5-6; Andre Gunder Frank, “The Development of Underdevelopment,” *Monthly Review* 18, 4 (September, 1966): 17-31.

⁴ Johan Galtung, “A Structural Theory of Imperialism”, *Journal of Peace Research*, 8, 2 (1971): 81-117.

Qeveria e Përkohshme e Vlorës përmbushte rolin e një “qendre brenda periferisë”: nga njëra anë, ajo synonte të ndërtonte infrastrukturën e nevojshme administrative dhe financiare për konsolidimin e shtetësisë; nga ana tjetër, varej nga mbështetja e jashtme dhe detyrohej të pranonte kushte që favorizonin interesat strategjikë të Fuqive të Mëdha. E njëjta situatë vijoi edhe gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, kur hapësira shtetërore shqiptare u pushtua nga Fuqitë e Mëdha.

Megjithatë, struktura binare austro-italiane nuk veproi në një vakuum gjeopolitik. Ajo u sfidua nga ndërhyrjet e Fuqive të Antantës, të cilat kundërshtonin monopolin e Fuqive të Adriatikut mbi Shqipërinë dhe synonin ta përfshinin vendin brenda një arkitekture më të gjerë diplomatike dhe ekonomike, në përputhje me interesat e tyre strategjikë në rajon dhe vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Në këtë kontekst, teoria e imperializmit strukturor nuk shpjegon vetëm marrëdhënien e dyfishtë midis Shqipërisë dhe Fuqive të Mëdha, por gjithashtu ofron një mjet analitik për të kuptuar natyrën shumëpalëshe të ndërhyrjeve perandorake dhe mënyrën se si këto ndikime kushtëzuan zhvillimin institucional dhe financiar të një shteti të ri dhe të dobët, siç ishte Shqipëria.

Në kuadër të një qasjeje teorike gjithëpërfshirëse, ndërtimi i sistemit bankar shqiptar analizohet edhe përmes thjerrës së teorisë së modernizimit (*Modernization Theory*). Kjo teori vendos në qendër të vëmendjes kalimin nga shoqëritë tradicionale drejt shteteve moderne përmes reformave institucionale, ndërtimit të kapaciteteve administrative dhe zhvillimit të një infrastrukture ekonomike, të krahasueshme me atë të vendeve perëndimore.⁵ Në këtë kontekst, elitat politike shqiptare, të ndërgjegjshme për domosdoshmërinë e këtij transformimi, aspiruan krijimin e një shteti funksional, modern dhe të integruar në sistemin europian.⁶ Megjithatë, në kushtet kur ky proces ndërmerrej përmes kapitalit të huaj dhe përfshirjes së drejtpërdrejtë të interesave të Fuqive të Adriatikut në administrimin e institucioneve financiare, ai merrte trajtën e një modernizimi të varur: një formë zhvillimi që, ndonëse krijonte

⁵ Ronald Inglehart & Christian Welzel, *Modernization, Cultural Change, and Democracy: The Human Development Sequence* (Cambridge: Cambridge University Press, 2005), 1-18, 19-30, 33-35.

⁶ Ledia Dushku “Let’s take our eyes off Turkey”! Perception on the Ottoman Turks in the discourse of the Provisional Government of Vlorë, *Balkan Studies*, Volume 53 (Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 2020), 79-102.

struktura të reja dhe formalisht moderne, mbështetej mbi një themel ekonomik të ndërmjetësuar dhe të kontrolluar nga Fuqitë e Mëdha.⁷

Konteksti politik dhe financiar: Sfidat e sovranitetit ekonomik dhe kontrolli ndërkombëtar

Pas Shpalljes së Pavarësisë dhe njohjes ndërkombëtare të shtetit shqiptar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër (29 korrik 1913), vendi u përball me sfidën e organizimit të brendshëm institucional dhe administrativ. Në këtë kuadër, një ndër aspektet më të ndjeshme ishte ngritja e një sistemi të qëndrueshëm financiar dhe monetar, si element kyç në procesin e shtetformimit. Shqipëria, e dalë nga shekuj të gjatë të administrimit osman, nuk trashëgonte institucione financiare kombëtare që mund të shërbenin si bazë për ndërtimin e një ekonomie të centralizuar dhe moderne, në përshtatje me kontekstin e ri.⁸

Fillimisht, Qeveria e Përkohshme e Vlorës ndërmori disa veprime emergjente. Banka Bujqësore Osmane u likuidua dhe degët e saj u vendosën nën administrimin e Ministrisë së Bujqësisë. Në maj 1913, me një vendim të posaçëm, të ardhurat që i takonin Borxhit Publik Osman (Dette Publique) u vendosën nën kontrollin e autoriteteve shqiptare. Ndonëse i diskutueshëm në planin diplomatik, ai i siguroi qeverisë të ardhura për ushtrimin e detyrave qeverisëse dhe përballimin e emergjencave, sikurse ishte sigurimi i ushqimeve për refugjatët e vendosur në Elbasan, Tiranë dhe Vlorë. Ndërhyrjet në sistemin fiskal ishin të kufizuara: u hoq taksa e luftës për kripën dhe u rrit tarifa doganore për importin e duhanit, për të nxitur prodhimin vendës.⁹ Megjithatë, struktura e sistemit tatimor osman, në thelb, mbeti e pandryshuar. Në aspektin monetar, vendi vazhdoi të përdorte monedha ari turke, italiane, franceze dhe pak angleze, si dhe të holla sermi e bakri

⁷ Për një trajtim teorik dhe historik të këtij koncepti, shih: Fernando Henrique Cardoso & Enzo Faletto, *Dependency and Development in Latin America* (Berkeley: University of California Press, 1979).

⁸ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2017), 244.

⁹ *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), F. 145, D. III-4.1, fl. 204. Vendim i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës për rritjen e taksës doganore të duhanit, Vlorë, 6 korrik 1913.

si valutë osmane, çka përfaqësonte një vazhdimësi të drejtpërdrejtë me sistemin e mëparshëm financiar.

Në këtë kontekst, nevoja për krijimin e një banke kombëtare dhe të një sistemi të qëndrueshëm monetar bëhej gjithnjë e më e domosdoshme për të ushtruar sovranitet real mbi territorin dhe për të garantuar funksionimin bazë të shtetit. Financimi i institucioneve të reja kërkonte burime të qëndrueshme dhe mekanizma funksionalë. Në mungesë të një thesari shtetëror efektiv, të një sistemi të strukturuar të të ardhurave dhe të një monedhe të unifikuar, qeveria pranoi ndihmën e jashtme financiare, pavarësisht nga natyra e saj kushtëzuese. Ideja e krijimit të një banke kombëtare përmes një koncesioni me kapital tërësisht të huaj përfaqësonte, kështu, një kompromis mes nevojës për ndërtim institucional dhe kufizimeve që impononte varësia ekonomike.

Ndërkohë vendimmarrja ndërkombëtare ndikoi në procesin e ndërtimit të institucioneve shqiptare. Konferenca e Ambasadorëve në Londër njohu pavarësinë e Shqipërisë dhe e vendosi vendin në një regjim ndërkombëtar mbikëqyrjeje përmes Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK).¹⁰ KNK-ja kishte autoritet të plotë mbi administratën shqiptare, përfshirë kontrollin e financave publike; kishte të drejtë të ndërhynte në përgatitjen e buxhetit; të kryente auditime financiare dhe të propozonte ndryshime pa konsultim paraprak me autoritetet shqiptare.¹¹ Ky mekanizëm u jepte Fuqive të Mëdha një instrument të drejtpërdrejtë për të ndikuar në formësimin e shtetit shqiptar, përfshirë edhe projektin për krijimin e një banke qendrore.

Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore i dha goditje të rëndë çdo përpjekjeje për konsolidim të brendshëm institucional dhe financiar. Projektet për krijimin e një banke kombëtare u pezulluan, ndërsa territori

¹⁰ Modele të ngjashme të mbikëqyrjes ndërkombëtare u aplikuan në disa vende ballkanike në fundin e shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Shih: Constantin Ardeleanu, *The European Commission of the Danube, 1856-1948: An Experiment in International Administration* (Leiden: Brill, 2020); Vera Zamagni, *The Economic History of Europe Since 1700* (Newcastle upon Tyne England: Agenda Publishing, 2017).

¹¹ Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, *Politisches Archiv, Albanien* (më tej: HHSSt.A.PA.A.), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: AIH), Vj. 24-44-4477. Rregullorja për organizimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe ushtrimi i funksioneve të tij, Vlorë, 30 prill 1914.

shqiptar u fragmentua në disa zona pushtimi.¹² Në klimën e pasigurisë politike dhe të mungesës së autoritetit të centralizuar, qarkullimi monetar u karakterizua nga një pluralizëm i theksuar. Krahas monedhave, në qarkullim nisën të përdoren edhe kartëmonedhat e vendeve pushtuese. Ky pluralizëm monetar nuk ishte thjesht një reflektim i paqëndrueshmërisë ekonomike, por në vetvete përfaqësonte ndarjen reale të territorit në sfera ndikimi të Fuqive të Mëdha. Çdo monedhë apo kartëmonedhë që qarkullonte mbartte jo vetëm vlerë ekonomike, por edhe simbolikë politike. Përdorimi i valutës së huaj nuk ishte një praktikë neutrale financiare, por një tregues i qartë i kontrollit gjeopolitik të Fuqive të Mëdha pushtuese, në hapësirën territoriale shqiptare.

Koncesioni bankar i vitit 1913: Projekt shtetformues nën hijen e varësisë strukturore

Krijimi i Bankës Kombëtare Shqiptare, në tetor të 1913-s, ishte rezultat i ndërthurjes së interesave të brendshëm shqiptarë për stabilizim shtetëror dhe fiskal me synimet strategjike të Austro-Hungarisë dhe Italisë në rajon. Qeveria e Përkohshme e Vlorës ishte e vetëdijshme se, pa një institucion qendror monetar, ekonomia shqiptare do të mbetej e paorganizuar dhe e paafte për t'u përballur me sfidat e shtetformimit. Ismail Qemali e artikuloi në mënyrë eksplicite këtë nevojë, duke theksuar se “edhe kombet më të fuqishme nuk mund të jetojnë pa kredi” e në këtë kuadër, Shqipëria e pavarur kishte “të drejtë të kishte një, ose edhe më tepër, banka” për të siguruar kredi për zhvillim.¹³

Krahas qeverisë, ideja për krijimin e një banke emetuese u diskutua edhe në rrethe të gjera politike dhe intelektuale jashtë saj, aty ku u propozua themelimi i bankës me kapitale shqiptare, të cilat mendohej se mund të siguroheshin brenda vendit dhe në diasporë.¹⁴ Megjithatë, ky

¹² Nicola Guy, *The Birth of Albania: Ethnic Nationalism, the Great Powers of World War I and the Emergence of Albanian Independence* (London: I.B. Tauris & Co. Ltd, 2012), 131-140.

¹³ “Çështja e qeverimit të Shqipëris dhe çështja e bankës”, *Përlindja e Shqipniës*, Vlonë, 5 nëntor 1913. Fjala e kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, Ismail Qemali, mbajtur në mitingun e Vlorës, 21 tetor 1913.

¹⁴ *Shqypnia e Re*, Shkodër, 16 tetor 1918, 2; shih edhe Sali Kadria, *Nacionalizmi Shqiptar në vitet 1912-1924*, ASA, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2020), 191-192.

vizion idealist përplasej me realitetin e vështirë ekonomik të kohës: Shqipëria e asaj periudhe nuk zotëronte kapacitete reale financiare për të krijuar e vetme një bankë kombëtare funksionale, ndërsa kishte nevojë për mbështetje ndërkombëtare. Për qeverinë shqiptare, burimet e brendshme vlerësoheshin të pamjaftueshme përballë nevojave të mëdha financiare që kishte një institucion i tillë, ndaj u ndoq një zgjidhje pragmatike përmes pranimit të kapitalit të huaj dhe ndjekjes së një politike të gjerë koncesionare.¹⁵

Austro-Hungaria dhe Italia ishin dy fuqitë më të interesuara dhe më aktive në këtë drejtim, duke ushtruar madje presion të drejtpërdrejtë për sigurimin e koncesioneve strategjike në Shqipëri, përfshirë edhe atë të bankës. Këto ambicie ishin pjesë e një strategjie të ndërtuar më herët në marrëveshjen e Monzës (1897) dhe notat diplomatike dypalëshe të viteve 1900-1901, të cilat përcaktonin respektimin e interesave të ndërsjellë në Shqipëri në rast të shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Parimi i paritetit mes Vjenës dhe Romës nënkuptonte se asnjëra prej tyre nuk do të duhej të kishte kontroll të njëanshëm; përkundrazi, ato do ta ndanin ndikimin në mënyrë të barabartë.¹⁶

Pavarësia e Shqipërisë vuri në provë këtë ekuilibër. Me krijimin e shtetit të ri, secila nga dy fuqitë kërkoi të mos mbetej prapa në pozicionimin strategjik. Banka Kombëtare u shfaq sakaq, jo vetëm si nevojë ekonomike për shqiptarët, por edhe si një mjet për shtrirjen e ndikimit financiar austro-italian. Siç vëren historiani Alessandro Roselli, Fuqitë e Adriatikut e kushtëzuan nisjen e punës së Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit Jugor me dhënien e koncesionit bankar, duke ia bërë të qartë kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, Ismail Qemalit se mbështetja për çështjet territoriale dhe procesin e njohjes ndërkombëtare do të varej nga bashkëpunimi në këtë drejtim.¹⁷ Në rrethanat e brishta të kohës kur mbijetesa e shtetit kushtëzohej nga

¹⁵ Qeveria e Përkohshme e Vlorës vendosi që zhvillimi i bujqësisë, ngritja e industrisë dhe ndërtimi i rrjetit të komunikacionit të bëhej përmes koncesioneve, të cilat do t'u jepeshin shoqërive të huaja sipas një rregulli të përcaktuar. Kaliopi Naska, "Politika ekonomike e Qeverisë së Vlorës (nëntor 1912 – janar 1914)", *Studime historike*, nr. 1 (1988): 88-89; Ledia Dushku, "The Adriatic Powers Parity and Albania (1912-1914): Desire and Reality", *West Bohemia Historical Review*, XIV (2024/1): 61-63.

¹⁶ Dushku, "The Adriatic Powers", 45-48.

¹⁷ Alessandro Roselli, *Italy and Albania: Financial Relations in the Fascist period* (London-New York: I.B. Tauris & Co. Ltd, 2006), 8-9.

vullneti i Fuqive të Mëdha, zgjedhja e Ismail Qemal Vlorës për të ndjekur një rrugë pragmatike ishte thujtse e pashmangshme. Ajo pasqyron në mënyrë paradigmatische varësinë strukturore në të cilën ndodhej Shqipëria: për të arritur një objektiv shtetformues, sikurse ishte krijimi i Bankës Kombëtare, ajo duhej të pranonte kushte që e thellonin varësinë nga Fuqitë e Adriatikut.

Ideja për krijimin e një banke kombëtare shqiptare u artikulua në mars të vitit 1913 në Vjenë dhe u intensifikua në qershor, atëherë kur u kristalizua si një ndërmarrje e përbashkët austro-italiane.¹⁸ Në kuadër të “*penetration pacifique*”,¹⁹ ministrat respektivë të Punëve të Jashtme, konti Berchtold dhe markezi San Giuliano, dakordësuan linjat themelore të projektit, të cilat më pas iu prezantuan kryetarit të qeverisë shqiptare gjatë vizitës së tij diplomatike në kryeqytetin habsburgas. Sipas studiuës Fabio Martelli, më 25 qershor 1913 Ismail Qemali nënshkroi një marrëveshje paraprake me përfaqësuesit e Wiener Bankverein dhe Banca Commerciale Italiana. Marrëveshja parashikonte krijimin e një banke qendrore me karakter të privilegjuar, e cila kishte të drejtën ekskluzive për emetimin e valutës në territorin shqiptar, me kapital fillestar prej 10 milionë koronash, të ndarë në mënyrë të barabartë midis dy grupeve bankare.²⁰ Në këtë mënyrë, politika e paritetit austro-italian pritej të konkretizohej edhe në fushën ekonomike, përmes një institucioni kyç si Banka Kombëtare.

Më 4 tetor 1913, Qeveria e Përkohshme e Vlorës nënshkroi marrëveshjen koncesionare për krijimin e Bankës Kombëtare Shqiptare me përfaqësuesit e Wiener Bankverein (Banka e Vjenës) dhe Banca Commerciale Italiana (Banka Tregtare Italiane). Koncesioni parashikonte krijimin e një banke me kapital tërësisht të huaj, të ndarë në mënyrë të

¹⁸ Për një trajtim të detajuar të procesit, shih: Peter Hertner, “Grassmachtrivalität und Kooperation im Adria-raum. Italien, Österreich-Ungarn und das Projekt einer albanischen Staatsbank, 1913/14”, *Quellen und Forschungen aus Italienischen Archiven und Bibliotheken*, 85 (2005): 272-317.

¹⁹ *Penetration pacifique – depërtim paqësor* – është një koncept i politikës së vonë imperialiste, i përdorur nga Fuqitë e Mëdha për të përshkruar përpjekjet për zgjerimin e ndikimit politik dhe ekonomik përmes mjeteve joushtarake: investimeve financiare, projekteve infrastrukturore, veprimtarive kulturore e fetare, si edhe ndihmës teknike. Shih: Kurt Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär: Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918* (Wiesbaden: Springer VS, 2018), 295-321; L. Dushku, “The Adriatic Powers”, 51-58.

²⁰ Fabio Martelli, *Capire ‘Albania* (Bologna: Il Mulino/Alfa Tape, 1998), 30.

barabartë midis dy palëve. Kohëzgjatja ishte 60 vjet, një periudhë shumë e gjatë që në praktikë i garantonte bankës kontroll afatgjatë mbi sistemin financiar shqiptar. Brenda këtij afati, konsorciumi do të gëzonte një sërë të drejtash ekskluzive, të cilat do të detajohen në vijim. Kontrata koncesionare mori fuqi ligjore të plotë pas ratifikimit nga konsorciumi bankar dhe publikimit të saj në gazetën zyrtare “Përlindja e Shqipërisë”.²¹ Ky publikim shënoi finalizimin formal të procesit dhe i dha transparencë publike marrëveshjes, duke informuar opinionin për krijimin e institucionit që do të luante një rol kyç në arkitekturën financiare të shtetit shqiptar.

Kushtet kryesore të marrëveshjes pasqyrojnë qartë kompromisin e arritur dhe, njëkohësisht, ndikimin vendimtar të Fuqive të Adriatikut mbi strukturën dhe funksionimin e bankës. Kapitali fillestar prej 10 milionë koronash austro-hungareze, ekuivalent me rreth 10,5 milionë lira italiane, do të ishte në ar. Ai nuk do të derdhej menjëherë, por pjesërisht, në përputhje me nevojat e bankës. Me vendim të Asamblesë së Aksionarëve parashikohej mundësia e shtimit të kapitalit, nëse aktiviteti bankar do ta kërkonte. Selia qendrore e Bankës Kombëtare do të vendosej në kryeqytetin e Shqipërisë, ndërsa banka kishte të drejtë të hapte degë dhe zyra brenda dhe jashtë vendit, sipas nevojave të veprimtarisë së saj, çka dëshmon për një vizion ambicioz të shtrirjes gjeografike.²²

Një aspekt kritik i marrëveshjes ishte struktura drejtuese e bankës. Këshilli i Administrimit do të përbëhej nga anëtarë në numër të barabartë nga të dyja grupet financiare themeluese, si dhe nga disa “elementë shqiptarë”. Në pamje të parë, kjo klauzolë linte të kuptohej se edhe pala shqiptare do të kishte një rol përfaqësues në drejtimin e institucionit, por dispozitat e detajuara e kufizonin ndjeshëm këtë përfshirje. Këshilli i parë do të përbëhej ekskluzivisht nga përfaqësues të grupeve bankare austro-hungareze dhe italiane, pa asnjë anëtar shqiptar. Vetëm në faza të mëvonshme parashikohej përfshirja eventuale e shqiptarëve në bord, por edhe atëherë me kushte të kufizuara: kandidatët shqiptarë duhej të përzgjidheshin nga një listë e dakordësuar më parë midis qeverisë shqiptare dhe vetë bordit, ndërsa emërimi i tyre do të bëhej nga Asambleja e Aksionarëve, një organ i dominuar nga kapitali i huaj. Kjo

²¹ “Banka Kombëtare Shqipëtare. Akt Konqesie”, *Përlindja e Shqipërisë*, Vlonë, 3 dhjetor 1913, 3.

²² Po aty.

procedurë e ndërlikuar i jepte palës aksionere fuqinë e vetos mbi çdo përfaqësues shqiptar. Për më tepër, brenda Këshillit të Administrimit parashikohej krijimi i një komiteti ekzekutiv, të përbërë nga dy ose katër anëtarë, të gjithë nga grupet financiare themeluese, pa asnjë pjesëmarrës shqiptar. Komiteti do të merrte vendimet e përditshme operationale, duke përqendruar kështu kontrollin praktik të institucionit në duart e kapitalit të huaj. Kjo strukturë reflektonte qartë asimetrinë e pushtetit dhe faktin që, ndonëse formalisht kombëtare, banka funksiononte në thelb si një instrument i kontrolluar nga interesat e jashtëm. Në këtë kuptim, modeli i saj institucional mishëronte parimin e varësisë strukturore (*Prebisch, Frank*), ku kapitali i huaj përcaktonte drejtimin e zhvillimit ekonomik, ndërsa elitat vendëse luanin rolin e “qendrës brenda periferisë”, sipas modelit të Galtung-ut, duke ndërmjetësuar interesa të jashtëm në emër të shtetformimit formal. Kështu, banka funksiononte jo vetëm si një mjet financiar, por edhe si një mekanizëm për integrimin e Shqipërisë në arkitekturën rajonale të pushtetit, në një marrëdhënie thellësisht të pabarabartë.

Pavarësisht se Banka Kombëtare do të funksiononte formalisht brenda kuadrit ligjor shqiptar, masat mbikëqyrëse në favor të shtetit shqiptar ishin minimale. Qeveria shqiptare kishte të drejtë të emëronte një komisar të lartë mbikëqyrës, i cili do të kontrollonte procesin e emetimit të kartëmonedhave dhe respektimin e statutit të bankës. Mirëpo, edhe ai nuk mund të emërohej pa pëlqimin paraprak të Këshillit Administrativ, ndërsa kompetencat e tij ishin të kufizuara. Ai nuk kishte të drejtë të ndërhynte në administrimin e përditshëm të bankës dhe as të merrte vendime që lidheshin drejtpërdrejt me politikat e saj monetare. Në praktikë, komisioneri shtetëror mund të raportonte shkelje, por nuk kishte autoritet ekzekutiv për t’i parandaluar ato.

Marrëveshja i garantonte Bankës Kombëtare një sërë privilegjesh ekskluzive në ekonominë shqiptare. Banka zotëronte monopolin e emetimit të valutës dhe vepronte si agjenti i vetëm financiar i qeverisë shqiptare, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Kjo nënkuptonte se ajo do të administronte qarkullimin e parasë, do të mbante thesarin shtetëror dhe do të kryente transaksionet financiare ndërkombëtare për llogari të qeverisë shqiptare. Për më tepër, neni 11 i marrëveshjes koncensionare i ofronte grupit austro-italian të drejtën e preferencës për të gjitha koncesionet ekonomike që Shqipëria do të jepte, si edhe për të gjitha punët publike apo furnizimet shtetërore që ajo do të realizonte. Kjo

dispozitë krijonte një monopol funksional, pasi çdo projekt i madh industrial, infrastrukturor apo financiar duhej t'u ofrohej fillimisht aksionarëve të Bankës Kombëtare. Vetëm nëse ata e refuzonin, projekti mund të kalonte te palë të treta.²³ Në këtë mënyrë, konsorciumi bankar nuk siguronte vetëm kontrollin mbi sektorin monetar, por edhe një pozicion dominues në zhvillimin ekonomik të vendit në fusha kyçe, si infrastruktura, minierat dhe shfrytëzimi i pasurive natyrore. Ky rregullim përbënte një përforsim të modelit të varësisë: zhvillimi ekonomik i Shqipërisë nuk bazohej në nismën vendëse apo kontrollin kombëtar, por ishte i varur drejtpërdrejt nga kapitali, vullneti dhe strategjitë e partnerëve të huaj, në rastin konkret të Austro-Hungarisë dhe Italisë. Në këtë kuptim, ai nuk është gjë tjetër veçse një ilustrim domethënës i tezës së Frank-ut dhe Prebisch-it mbi “zhvillimin e nënzhvillimit”, një proces ku çdo iniciativë vendëse mbetet dytësore përballë strukturës së kontrollit të huaj, duke riprodhuar në mënyrë të qëndrueshme marrëdhënie vartësie.²⁴

Duhet theksuar se Ismail Qemali u përpoq të bënte disa korrigjime në tekstin e marrëveshjes, me qëllim ruajtjen, qoftë edhe të pjesshme, të interesave shqiptarë. Një nga ndërhyrjet e tij më domethënëse ishte shtesa në nenin 21, e cila parashikonte se, në rast mosmarrëveshjeje midis qeverisë shqiptare dhe bankës lidhur me interpretimin ose zbatimin e koncesionit, çështja t'i nënshtrohej Gjykatës Federale të Lozanës në Zvicër, dhe vendimi i saj të ishte i detyrueshëm për zbatim.²⁵ Me këtë dispozitë, Ismail Qemali shmangu zgjidhjen e konflikteve në gjykatat e vendeve aksionere, ku ndikimi politik austro-italian mund të kishte rezultuar i njëanshëm. Ai preferoi një juridiksion ndërkombëtar neutral, duke treguar vetëdije për rrezikun e abuzimit dhe për nevojën e një mekanizmi mbrojtës minimal. Megjithatë, ndërhyrja e tij përfaqësonte një

²³ Po aty.

²⁴ Teza e *development of underdevelopment* u artikulua për herë të parë nga André Gunder Frank në artikullin e tij klasik “The Development of Underdevelopment” (1966), ku ai argumenton se zhvillimi ekonomik në qendër shkon paralelisht me nënzhvillimin e periferisë, nëpërmjet një strukture marrëdhëniesh të pabarabarta historike dhe ekonomike. Shih: André Gunder Frank, “The Development of Underdevelopment,” *Monthly Review*, Vol. 18, No. 4 (1966): 17-31. DOI: <https://doi.org/10.14452/MR-018-04-1966-08>. Në lidhje me këtë aspekt, shih gjithashtu: Raúl Prebisch, *The Economic Development of Latin America and Its Principal Problems*, United Nations, Departament of Economic Affairs (Lake Success, New York: 1950).

²⁵ Dushku, “The Adriatic Powers”, 60.

garanci më shumë formale sesa reale, përballë pozitës jashtëzakonisht të favorshme që iu garantua konsorciumit austro-italian. Kjo përpjekje për të vendosur një mekanizëm neutral ndërkombëtar mund të shihet si një akt i kufizuar shtetformimi në kuptimin e teorisë së Tilly-t, ku qeveria shqiptare synonte të afirmonte një shkallë minimale sovraniteti institucional. Por njëkohësisht, pamundësia për të ndryshuar balancën reale të pushtetit reflekton varësinë strukturore të Shqipërisë si periferi, ku aktorët qeverisës vendës operonin brenda kufizimeve të imponuara nga interesat e kapitalit të huaj dhe nga arkitektura politike e Fuqive të Mëdha. Kështu, tensioni midis afirmimit simbolik të sovranitetit dhe realitetit të kontrollit të jashtëm mishëronte ndërveprimin e shteteve të dobëta me strukturat e varësisë globale. Kjo asimetri nuk kaloi pa reagim në planin e brendshëm: në opinionin publik shqiptar dhe faktorin opozitar, banka u perceptua si “jopopullore”, pasi – siç shprehej konsulli austro-hungarez Kral – ajo “konsiderohej si një instrument për shfrytëzimin e vendit nga të huajt dhe përjashtonte kapitalin vendas”.²⁶

Me nënshkrimin e koncesionit, Banka Kombëtare Shqiptare u krijua formalisht, por ajo nuk arriti të zhvillonte veprimtari të mirëfilltë bankare. Në fund të vitit 1913 dhe në fillim të vitit 1914, infrastruktura institucionale e bankës ishte ende në formim e sipër, ndërsa çështje të rëndësishme, si përcaktimi i selisë qendrore (ende nuk ishte përcaktuar kryeqyteti i Shqipërisë) apo nisja e emetimit të monedhës, kishin mbetur të pazgjidhura. Sipas financierit Haxhi Shkoza, veprimi i vetëm konkret financiar i Bankës Kombëtare pas krijimit të saj ishte pranimi i një depozite prej 545 283 groshësh nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës në tetor 1913. Rreth gjysma e shumës u tërhoq nga kjo e fundit në tre këste, ndërsa pjesa tjetër mbeti e depozituar deri në qershor 1914, pa të dhëna të mëvonshme për fatin e saj.²⁷

Dokumentacioni i konsultuar së fundmi ofron tregues të fortë se Banka Kombëtare Shqiptare ka përfituar fonde nga të dyja grupet themeluese financiare, në formën e një depozite me karakter huaje. Fondet përbënin një transferim institucional të huas prej 10 milionë frangash që Austro-Hungaria dhe Italia i akorduan Princit Wilhelm von Wied, i caktuar nga Fuqitë e Mëdha si sovran i shtetit shqiptar, si garanci

²⁶ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj. 27-1-143. Raport i konsullit Kral për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Shkodër, 10 shtator 1917.

²⁷ Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë (1839-1934)*, (Tiranë: Shtypshkronja “Nikaj”, 1935), 779-780.

për ardhjen e tij në Shqipëri. Kontrata mban datën 21 mars 1914 dhe është realizuar midis qeverisë shqiptare të Turhan Pashë Përmetit, Wiener Bankverein dhe Banca Commerciale Italiana. Kjo hua, e përcaktuar si “emergjente” dhe e konceptuar si mjet për funksionimin e Principatës Shqiptare, parashikonte të kishte garanci të ardhurat doganore të shtetit shqiptar dhe huan e plotë ndërkombëtare prej 75 milionë frangash, dakordësia për lëvrimin e së cilës nuk ishte arritur ende nga të gjitha Fuqitë e Mëdha. Kushtet e kontratës nuk ishin fort të favorshme për palën shqiptare: përveç kontrollit mbi të ardhurat doganore, ajo përfshinte interesa të lartë dhe penalitete shtesë në rast vonese, ndërsa KNK-ja ishte institucioni që do të realizonte mbikëqyrjen e zbatimit të huas, kjo e fundit një kërkesë e fuqive të Antantës.²⁸ Pavarësisht se Banka Kombëtare Shqiptare nuk përmendet formalisht në tekstin e kontratës si palë apo ndërmjetës financiar, është e arsyeshme të supozohet se fondet e huas austro-italiane mund të jenë kanalizuar përmes saj. Dokumentacioni i deritanishëm nuk ofron një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të verifikueshme, por treguesit historikë sugjerojnë se Banka Kombëtare mund të ketë pasur një rol të heshtur, ndoshta teknik apo logjistik, për transferimin dhe më tej administrimin e huas, duke u pozicionuar si një instrument potencial i ndërhyrjes financiare ndërkombëtare, në mbështetje të strukturave të brishta shtetërore shqiptare.

Pavarësisht nga përfshirja e mundshme, aktiviteti real financiar i Bankës Kombëtare Shqiptare mbeti jashtëzakonisht i kufizuar, duke dëshmuar se ky institucion ishte në thelb një strukturë më shumë e ndërtuar në letër sesa e mishëruar në praktikë. Ajo nuk arriti të ushtronte funksionet themelore të parashikuara si bankë emetuese dhe agjent financiar i shtetit shqiptar. Ky dështim duhet interpretuar në dritën e dy faktorëve kryesorë: nga njëra anë, dobësisë së brendshme institucionale të shtetit shqiptar, i cili ende ndodhej në fazat embrionale të organizimit; nga ana tjetër, rivaliteteve mes Fuqive të Mëdha dhe zhvillimeve ndërkombëtare destabilizuese që çuan në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, ngjarje që jo vetëm përmbysi arkitekturën e re shtetërore, por edhe shtyu në kohë çdo përpjekje për ndërtimin e një sistemi financiar

²⁸ *Banca Commerciale Italiana*, Fondo SG35, Fasc.15 - Contrat / Patrimonio BCI. Kontratë e qeverisë shqiptare me Wiener Bank-Verein dhe Banca Commerciale Italiana, Durrës, 21 mars 1914 (dokumenti është vënë në dispozicion të autores së këtij artikulli nga Besa Prella, përgjegjëse sektori në Departamentin e Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë).

funksional. Në këtë dritë, Banka Kombëtare përfaqëson një nga shembujt më domethënës të tensionit ndërmjet ambicies për konsolidim e modernizim shtetëror dhe realitetit të brishtë ndërkombëtar në prag të luftës botërore, ku Shqipëria, si një shtet periferik dhe i sapoformuar, operonte brenda një arkitekture rajonale që e mbante të varur nga interesat dhe dinamikat e Fuqive të Mëdha.

Përpjekjet për ndërkombëtarizimin e bankës kombëtare dhe kolapsi i projektit shtetformues në Shqipëri

Me themelimin formal të Bankës Kombëtare, Austro-Hungaria dhe Italia dukeshin se kishin siguruar një pozicion të konsoliduar ekonomik në Shqipëri. Por konteksti gjeopolitik evropian dhe parimet e vendosura në Konferencën e Ambasadorëve në Londër për Shqipërinë nuk lejuan krijimin e një monopoli austro-italian në dëm të interesave të fuqive të tjera. Më 16 tetor 1913, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit filloi aktivitetin në Vlorë, dhe anëtarët e tij u njohën me përmbajtjen e marrëveshjes koncesionare për krijimin e bankës.²⁹ Për Fuqitë e Antantës (Britaninë e Madhe, Francën dhe Rusinë), marrëveshja përbënte një akt të njëanshëm, i cili binte në kundërshtim me parimin e kujdestarisë kolektive të vendosur në Londër.³⁰

Si rrjedhojë, nisën diskutimet për ndërkombëtarizimin e Bankës Kombëtare, me synimin për të përfshirë në kapitalin dhe strukturën e saj drejtuese të gjitha Fuqitë e Mëdha, në një marrëdhënie pariteti mes tyre. Diskutimet u lidhën ngushtësisht me çështjen e dhënies së huas ndërkombëtare prej 75 milionë frangash për shtetin shqiptar, kërkesë e parashtruar edhe nga Princi Wilhelm von Wied si një nga kushtet për

²⁹ Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (*Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik*), përgatiti për botim Arben Puto, vëll. II (1912-1918), (Tiranë: 8 Nëntori, 1987), 467-470; 478-480.

³⁰ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, përgatiti për botim Valentina Duka (Tiranë: Toena, 2012), 103. Ambasadori britanik në Gjermani për sekretarin e Punëve të Jashtme, 16 janar 1914; *po aty*, 147-148. Ambasadori britanik në Romë për sekretarin e Punëve të Jashtme, 31 janar 1914; *po aty*, 171-172. Sekretari britanik i Punëve të Jashtme për ambasadorin në Vjenë, 10 shkurt 1914; *po aty*, 222-225. Sekretari britanik i Punëve të Jashtme për ambasadorin në Shën Petersburg, 4 mars 1914.

pranimin e fronit shqiptar.³¹ Në mënyrë të përsëritur që prej dhjetorit 1913, shtetet e Antantës deklaruan se do të merrnin pjesë në garantimin e huas, vetëm nëse “Banka Kombëtare do të ndërkombëtarizohej dhe KNK do të merrte në dorë organizimin administrativ e financiar të Shqipërisë, si edhe do të ushtronte kontrollin e huas”.³² Në thelb të këtij qëndrimi ishte frika se kontrolli ekskluziv i Austro-Hungarisë dhe Italisë mbi Bankën Kombëtare do të krijonte një pabarazi të rrezikshme influencash, e cila jo vetëm do të minonte parimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, por do të kërcënonte stabilitetin e brendshëm të shtetit shqiptar, veçanërisht nëse përkeqësoheshin marrëdhëniet mes Fuqive të Adriatikut, sikurse edhe ndodhi në kushtet e Luftës së Parë Botërore. Qartazi, ky proces nuk përfaqësonte vetëm imponimin klasik të kushteve nga qendra ndaj periferisë, por ilustronte në mënyrë shembullore mekanizmin e imperializmit strukturor të Johan Galtung-ut: jo vetëm që qendra përcaktonte agjendën e zhvillimit në periferinë shqiptare, por edhe rivalitetet mes vetë Fuqive të Mëdha (Austro-Hungaria, Italia, Britania, Franca), shërbenin si faktorë që kufizonin më tej hapësirën autonome të vendimmarrjes, duke e reduktuar sovranitetin e Shqipërisë në funksion të balancave ndërkombëtare mes vetë të Mëdhenjve.³³

Gjatë muajve janar-korrik 1914, bisedimet mbi statusin dhe strukturën e bankës u intensifikuan. Fuqitë e Antantës kërkuan përfshirjen në kapitalin e bankës në kushte të barabarta me Austro-Hungarinë dhe Italinë, çka nënkuptonte transformimin nga një koncesion dypalësh në një ndërmarrje shumëpalëshe, ku secila nga gjashtë Fuqitë e Mëdha duhej të kishte pjesëmarrje të barabartë në kapitalin themeltar të bankës dhe të drejtën e përfaqësimit në strukturat e saj drejtuese.³⁴

Edhe pse në fillim hezituan, Austro-Hungaria dhe Italia gradualisht zbutën qëndrimet dhe u përfshinë në procesin e negociimit për të arritur një kompromis diplomatik. Deri në qershor 1914 u arrit një marrëveshje e

³¹ *AIH*, A-VI-13, “Politika e kabineteve europiane prej shtator 1913 gjer në korrik 1914”, fl. 1170-1173. Zëvendësdelegati gjerman në KNK për kancelarin e Rajhut, 15 dhjetor 1913.

³² *Po aty*.

³³ Galtung, “A Structural Theory of Imperialism”, 81-117.

³⁴ L. Dushku, “Pariteti austro-hungaro-italian, Banka Kombëtare Shqiptare dhe Fuqitë e Mëdha (1913-1914), *Shqiptarët dhe ndërkombëtarët në vitet 1912-1926*. Akte të konferencës shkencore (25 tetor 2019), përgatitja dhe redaktimi Ledia Dushku, ASA/Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2019), 44-45.

pjesshme: Fuqitë e Adriatikut pranuan ndërkombëtarizimin e përkohshëm të bankës, me kushtin e garancisë për një pozicion të privilegjuar, si zotëruese të 60% të kapitalit të bankës, për shkak të interesave të veçantë që ato kishin në Shqipëri.³⁵ Në vijim, diskutimet u përqendruan në ndarjen e pozicioneve kyçe për administrimin praktik të institucionit. Gatishmëria e Vjenës për të ndarë kapitalin dhe përfaqësimin formal në bord me fuqitë e tjera u kushtëzua me ruajtjen e kontrollit efektiv përmes drejtimit ekzekutiv të bankës, një synim i qartë për të mbrojtur interesat strategjikë dhe për të garantuar vazhdimësinë e ndikimit austro-italian mbi institucionin financiar shqiptar. Kjo formulë kompromisi u shqyrtua në tryezat diplomatike, por negociatat për strukturën përfundimtare të bankës ngecën për shkak të mosmarrëveshjeve mes Austro-Hungarisë dhe Fuqive të Antantës. Më delikatja ndër to ishte emërimi i guvernatorit të bankës, funksionarit më të lartë ekzekutiv dhe përfaqësuesit zyrtar të bankës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në një qëndrim të bashkënduar, Fuqitë e Antantës propozuan që guvernatori të ishte britanik.³⁶ Në optikën e tyre, Britania e Madhe, si një fuqi financiare me peshë globale dhe me pozicion neutral, do të garantonte funksionimin profesional të bankës, duke shmangur transformimin e saj në një instrument të politikës së jashtme austro-italiane. Ndonëse Italia u tërhoq, Austro-Hungaria këmbënguli që guvernatori të ishte austriak ose hungarez, duke argumentuar se një pjesë e konsiderueshme e kapitalit fillestar ishte zotëruar nga grupet e saj bankare. Negociatat mbi strukturën përfundimtare të Bankës Kombëtare u zvarritën gjatë gjithë verës së vitit 1914, pa arritur marrëveshje për ndarjen paritare të aksioneve dhe drejtimit të bankës.

Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore përmbysi dinamikën politike dhe diplomatike në Europë e në Ballkan. Vëmendja e Fuqive të Mëdha u zhvendos plotësisht drejt fushëbetëve, ndërsa projekti për Bankën Kombëtare të Shqipërisë u la në heshtje dhe nuk u rikthye më në diskutimet ndërkombëtare. Largimi i Princ Wied-it nga vendi, më 3 shtator 1914, shënoi fundin e përpjekjeve për ndërtimin e një shteti funksional: qeveria dhe KNK-ja u larguan, vendi ra në kaos, i ndarë

³⁵ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët...*, 171-172. Sekretari britanik i Punëve të Jashtme për ambasadorin në Vjenë, 10 shkurt 1914.

³⁶ Dushku, "The Adriatic Powers", 63.

midis fraksioneve të brendshme dhe forcave të huaja pushtuese.³⁷ Në maj 1915, me hyrjen në luftë të Italisë përkrah Antantës dhe kundër Austro-Hungarisë, u shkatërrua çdo mundësi e mëtejshme bashkëpunimi midis Fuqive të Adriatikut.

Monedha pa shtet: Nismat bankare dhe monetare gjatë Luftës së Parë Botërore

Pavarësisht nga kolapsi institucional, gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918), Shqipëria mbeti një territor i copëzuar dhe i pushtuar, pa një qeverisje kombëtare. Kjo periudhë shënon një nga momentet më të errëta për procesin e shtetformimit, duke përfshirë edhe sferën financiare. Territori shqiptar mbeti i integruar në sistemet monetare të fuqive pushtuese: koronës austro-hungareze në Veri dhe qendër, lirës italiane në Jug dhe frangës franceze në Korçë e zonat përreth. Kjo gjendje e fragmentimit monetar jo vetëm që zëvendësoi përkohësisht çdo projekt për një sistem bankar kombëtar, por pengoi krijimin e një tregu të integruar financiar dhe minoi themelet e një autoriteti shtetëror të centralizuar. Në këtë kontekst, ndërprerja e procesit të shtetformimit nuk ishte vetëm rezultat i dobësisë së brendshme institucionale, por edhe mishërim i plotë i modelit të Galtung-ut për marrëdhëniet qendër-periferi: një territor i varur dhe i kontrolluar nga qendra të huaja, ku strukturat e tyre monetare dhe financiare zëvendësonin institucionet vendore, duke e mbajtur Shqipërinë në një pozitë të thellë vartësie ekonomike dhe politike.

Në vitin 1916, pas përparimit të trupave të saj në Ballkan, Austro-Hungaria pushtoi pjesën veriore dhe qendrore deri në lumin Vjosë. Territori i pushtuar u vendos nën administrim ushtarak, ndërsa Shqipëria u trajtua si vend “mik” i pushtuar, për arsye të operacioneve ushtarake kundër shteteve të tjera ndërluftuese.³⁸ Grumbullimi i arit, pasiguria dhe konfuzioni në tregti, shkaktuar nga qarkullimi i monedhave të ndryshme, si edhe zhvlerësimi i vazhdueshëm i koronës letër, e detyruan administratën austro-hungareze që, në qershor të 1916-s, të hapte në Shkodër një degë të Wiener Bankverein. Më vonë, më 1 tetor 1917, po

³⁷ Guy, *The birth of Albania*, 82-84; Romeo Gurakuqi, “Shqipëria dhe Shkodra në periudhën gusht 1914 - shkurt 1916”, *Kuvendi*, nr. 10 (2018): 59-66.

³⁸ Gentiana Kera, Enriketa Pandelejmoni, “Austrian-Hungarian military administration in Albania during World War I”, *Foreign Policy Review*, Volume 15 (2022/1): 32-48.

aty u hap edhe dega e Pesti Magyar Kereskedelmi Bank (Banka Tregtare Hungareze e Pestit) e cila, së bashku me Bankën Vjeneze, mbetën të vetmet institucione bankare që vepruan në zonën austro-hungareze deri në përfundimin e Luftës së Parë Botërore.³⁹

Sakaq, në rrethet tregtare shkodrane u hodh ideja për krijimin e një institucioni bankar shqiptar, ide e cila nuk siguroi mbështetje as nga Wiener Bankverein, as nga Ministria e Jashtme dhe autoritetet ushtarake në Shkodër. Projekti u konsiderua i papërshtatshëm, me arsyetimin se mund të krijonte një precedent që do të pengonte realizimin e planeve të Austro-Hungarisë në Shqipëri. Duhej pritur përfundimi i luftës dhe zgjidhja përfundimtare e statusit ndërkombëtar të saj për të proceduar me themelimin e një banke kombëtare shqiptare, qoftë në bazë të koncesionit të tetorit 1913, qoftë përmes një strukture të re bankare që përjashtonte pjesëmarrjen italiane.⁴⁰ Për të shmangur pakënaqësinë e opinionit vendës, drejtuesit e bankës vjeneze propozuan zgjerimin me nëpunës shqiptarë të degës në Shkodër, propozim që u mbështet nga autoritetet ushtarake dhe diplomatike austro-hungareze. Gjithashtu, u sugjerua formimi i një shoqërie tregtare shqiptare, e cila do të funksiononte si shoqëri me kapital të kufizuar, ku aksionet do të ndaheshin pothuajse në mënyrë të barabartë midis tregtarëve shqiptarë (49%) dhe Wiener Bankverein (51%).⁴¹

Këto përpjekje, të dokumentuara nga korrespondenca diplomatike e kohës, kishin për qëllim administrimin financiar dhe politik të zonës së pushtuar, sigurimin e likuiditetit për ushtrinë dhe popullsinë vendëse, si dhe përgatitjen e një rendi të ri ekonomik pas përfundimit të luftës, me Shqipërinë të përfshirë brenda sferës së ndikimit austro-hungarez. Megjithatë, rezultatet mbetën të kufizuara dhe deri më sot nuk disponojmë dëshmi që të vërtetojnë realizimin konkret të propozimeve të mësipërme.

Nga ana tjetër, Italia pushtoi Vlorën në tetor 1914 dhe më pas zgjeroi praninë e saj në jug të lumit Vjosë, si rivale e drejtpërdrejtë strategjike e Austro-Hungarisë. Në tërësi, italianët zbatuan një regjim të centralizuar, ku ushtarakët kishin kompetenca të gjera edhe mbi

³⁹ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj. 27-2-251. Memorandum mbi rregullimin e çështjes valutore dhe të grumbullimit të lëndës së parë në Shqipëri, Baden, 19 dhjetor 1917.

⁴⁰ *Po aty*, Vj. 27-1-144. Projekti për themelimin e një banke në Shqipëri. Propozimi i Wiener Bankverein, Vjenë, 5 tetor 1917.

⁴¹ *Po aty*, Vj. 27-1-142. Projekti i Wiener Bankverein për përfaqësuesin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shkodër, konsullin Kral, Vjenë, 19 tetor 1917.

administratën civile, e cila vepronte nën “Sekretariatën për çështjet civile të Shqipërisë”.⁴² Kontrolli i suksesshëm i territorit, krahas pranisë së fortë ushtarake, u shoqërua edhe me një mbështetje të qëndrueshme ekonomike. Edhe pse nuk pati iniciativa për krijimin e një banke shqiptare, veprimet italiane në fushën financiare përfshinin lëshimin e licencave, hartimin e projekteve investuese dhe përdorimin e lirës, çka tregon për zbatimin e një politike *de facto* protektorati, si parapërgatitje për politikën e pasluftës.⁴³

Ndërkohë, Franca pushtoi Korçën dhe zonat përreth në juglindje të Shqipërisë dhe, në bashkëpunim me vendësit, themeloi “Republikën Autonome të Korçës” (1916-1918). Brenda këtij kuadri u ngrit një strukturë vetëqeverisëse shqiptare nën mbikëqyrjen franceze, me përdorimin e frangës franceze si valutë zyrtare dhe ngritjen e Drejtorisë së Financave për administrimin e çështjeve fiskale. Bankë në kuptimin formal të fjalës nuk u krijua, por autoritetet vendore ndërmorën një nismë të veçantë për emetimin e kartëmonedhës vendëse, si instrument lokal me funksione praktike dhe rol simbolik në afirmimin e autonomisë vendore. Më 27 janar 1917, Këshilli qeveritar autorizoi prerjen e bonove të quajtura “franga”, të cilat hynë në qarkullim më 1 mars.⁴⁴

Veç përmasës ekonomike, bonot kishin edhe një strukturim të kujdesshëm vizual dhe simbolik. Ato mbanin në qendër shqiponjën me dy krerë, një simbol historik i shtetësisë shqiptare, ndërsa sipër saj shkruhej “Shqipëri vetëqeveritare”, me emërtimin e qytetit “Korçë” në fund dhe vlerën përkatëse në krah.⁴⁵ Këto elemente dëshmojnë përpjekjen e vetëdijshme për të artikuluar një identitet kombëtar shqiptar përmes një instrumenti monetar lokal. Ky emetim, ndonëse jashtë një sistemi të mirëfilltë bankar, përfaqësonte një përpjekje të qartë për të ushtruar autoritet monetar në kushtet e fragmentimit politik dhe të mungesës së një shteti funksional. Ai shërbente si një formë e hershme e modernizimit

⁴² Sali Kadria, *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*, ASA/Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2020), 305.

⁴³ Për më shumë mbi politikën italiane në Shqipëri, shih: Alessandro Borgogni, *Tra continuità e incertezza. Italia e Albania (1914-1939). La strategia politico-militare dell'Italia in Albania fino all'Operazione "Oltre Mare Tirana"* (Milano: Franco Angeli, 2007).

⁴⁴ Kaliopi Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve "Adriatiku" dhe "Gazet' e Korçës" (dhjetor 1916-gusht 1917). Trajtesë dhe dokumente* (Tiranë: Kristalina KH, 2017), 63.

⁴⁵ *Po aty*.

simbolik, ku monedha nuk ishte vetëm një instrument shkëmbimi, por një mjet për artikulumin vizual dhe politik të shtetësisë shqiptare në mungesë të sovranitetit të plotë.⁴⁶ Megjithatë, për shkak të mungesës së një strukture bankare kombëtare, kjo nismë mbeti e kufizuar dhe e varur nga mbikëqyrja franceze.

Në përfundim të luftës, në nëntor 1918, ideja për një bankë kombëtare shqiptare mbeti ende në sferën e aspiratave të parealizuara. Shqipëria doli nga lufta pa institucione bankare funksionale, me një ekonomi të shpërbërë dhe me nevoja urgjente për financim, stabilitet monetar dhe rindërtim. Përvoja e kësaj periudhe konfirmoi se, edhe në mungesë të shtetit, kontrolli mbi mjetet monetare vazhdoi të përbente një instrument strategjik për Fuqitë e Mëdha, që kërkonin të projektonin ndikimin e tyre në Shqipëri. Për këtë arsye, monedha në këtë periudhë fliste më shumë për marrëdhëniet e pushtetit sesa për ato të tregut.

Përfundime

Përvoja shqiptare e viteve 1913-1918 dëshmon qartë se ndërtimi i shtetit në një kontekst të pasigurt politik dhe ndërkombëtar u shoqërua me tension të vazhdueshëm midis ambicieve për sovranitet dhe kufizimeve të imponuara nga arkitektura globale e pushtetit. Projekti për krijimin e një banke kombëtare – një element themelor për konsolidimin institucional dhe kontrollin ekonomik – u konceptua si një gur themeli i shtetformimit modern. Megjithatë, dobësia e brendshme shtetërore dhe varësia nga kapitali i huaj e shndërruan këtë projekt në një mjet për projektimin e interesave gjeopolitikë të Fuqive të Mëdha, duke treguar se ndërtimi i institucioneve në kushte të pasigurta mund të prodhojë struktura formale pa përmbajtje të pavarur. Kësisoj, periudha 1913-1918

⁴⁶ Koncepti i *modernizimit simbolik* i referohet procesit përmes të cilit shtetet e reja ose të brishta kërkojnë të artikulojnë identitetin dhe legjitimitetin e tyre përmes simboleve vizuale, institucioneve përfaqësuese dhe mjeteve publike të komunikimit, si monedha, flamuri, dokumentet zyrtare etj. Në këtë kuptim, në kushtet e mungesës së një autoriteti shtetëror, elementet simbolike luajnë një rol thelbësor në krijimin e një përfytyrimi kolektiv mbi shtetin. Shih: Benedict Anderson, *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism*, Rev. ed. (London: Verso, 2006), 9-36, 187-205; Eric Hobsbawm, "Introduction: Inventing Traditions", *The Invention of Tradition*, edited by Eric Hobsbawm and Terence Ranger (Cambridge: Cambridge University Press, 1983), 1-14.

nuk përfaqëson thjesht një kapitull të mbyllur të historisë financiare, por edhe një precedent të rëndësishëm për të kuptuar trajktoren e mëvonshme të varësisë strukturore në Shqipëri.

Pas vitit 1920, përvoja e dështuar e Bankës Kombëtare të vitit 1913 nuk u harrua. Ajo u risoll në vëmendje në vitet 1921-1924, kur nisën debatet për nevojën e krijimit të një banke shtetërore. Me ardhjen në pushtet të Ahmet Zogut si President i Republikës Shqiptare (1925), çështja mori trajtim konkret. Themelimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, në kuadër të marrëveshjeve me Italinë, ishte formalisht një vijimësi e projektit të vitit 1913, duke ilustruar vijueshmërinë e modelit të varësisë. Kapitali italian dominoi dhe banka u shndërrua në një instrument të imperializmit ekonomik italian. Përpjekja për sovranitet financiar përfundoi sërish në varësi strukturore, por këtë herë nën kontrollin e një fuqie të vetme.

Ky zhvillim dëshmoi se modeli i varësisë nuk ishte episodik, por vijues, në shtete periferike dhe të dobëta si Shqipëria. Ideja e një banke kombëtare si element i shtetformimit mbeti e lidhur ngushtësisht me ndërhyrjen e jashtme. Emetimi i frangës shqiptare në vitin 1926 u bë i mundur vetëm pasi u krijua një bankë qendrore me kapital dhe drejtim të huaj. Italia, në këtë kontekst, arriti të realizonte e vetme atë që në vitin 1913 ndante me Austro-Hungarinë: kontrollin mbi financat shqiptare. Varësia u thellua më tej përmes koncesioneve në sektorë strategjikë, si nafta dhe minierat.

Në këtë kuadër, periudha 1913-1918 përcaktoi kornizën konceptuale dhe praktike të zhvillimeve financiare të Shqipërisë edhe në dekadën që pasoi. Modeli i bankës qendrore vijoi të përputhej me tezën e varësisë: ndonëse institucioni bankar u konceptua si pjesë e projektit të ndërtimit të shtetit, në praktikë ai u imponua nga interesat e kapitalit italian. Banka u bë kështu më tepër një mekanizëm kontrolli sesa një instrument i pavarësisë kombëtare. Ndërkohë, qasja modernizuese evidentoi tensionin mes formës dhe përmbajtjes: shteti synonte të ndërtonte struktura moderne, por pa siguruar kontrollin real mbi to: një modernizim i “eksportuar”, që krijonte pamje shtetësie, por jo sovranitet efektiv.

Për të gjitha sa më sipër, fillimet e sistemit bankar në Shqipërinë e viteve 1913-1918 nuk përfaqësojnë vetëm një episod të historisë financiare shqiptare. Ato përbëjnë një rast studimor paradigmatic për analizën e kufizimeve strukturore të shtetformimit në kontekste

periferike, aty ku ambicia për shtet kombëtar dhe modernitet bie ndesh me realitetin e një varësie të institucionalizuar.

Burime e bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

- F. 145

Arkivi i Institutit të Historisë (AIH)

- Fondi i dokumenteve austro-hungareze, viti 1913-1917
- Politika e kabineteve europiane prej shtatorit të vitit 1913 gjer në korrik 1914

Banca Commerciale Italiana

- Fondo SG35, Fasc. 15 – Kontratë e qeverisë shqiptare me Wiener Bankverein dhe Banca Commerciale Italiana, Durrës, 21 mars 1914

Burime arkivore të botuara:

DUKA, Valentina (përg.). *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*. Tiranë: Toena, 2012.

PUTO, Arben (përg.). *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, vëll. II (1912-1918)*. Tiranë: 8 Nëntori, 1987.

Literaturë:

ANDERSON, Benedict. *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism*. Rev. ed. London: Verso, 2006.

ARDELEANU, Constantin. *The European Commission of the Danube, 1856-1948*. Leiden: Brill, 2020.

BORGOGNI, Alessandro. *Tra continuità e incertezza. Italia e Albania (1914-1939)*. Milano: Franco Angeli, 2007.

CARDOSO, Fernando Henrique, and Enzo Faletto. *Dependency and Development in Latin America*. Berkeley: University of California Press, 1979.

DUSHKU, Ledia. "Let's Take Our Eyes off Turkey!" *Balkan Studies* 53 (2020): 79-102.

DUSHKU, Ledia. "Pariteti austro-hungaro-italian, Banka Kombëtare Shqiptare dhe Fuqitë e Mëdha (1913-1914)." In *Shqiptarët dhe*

- ndërkombëtarët në vitet 1912-1926*. ASA/Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2019.
- DUSHKU, Ledia. "The Adriatic Powers Parity and Albania (1912-1914)." *West Bohemia Historical Review* XIV (2024/1): 45-63.
- FRANK, Andre Gunder. "The Development of Underdevelopment." *Monthly Review* 18, no. 4 (1966): 17-31.
- FRANK, Andre Gunder. *Capitalism and Underdevelopment in Latin America*. New York-London: Monthly Review Press, 1967.
- GALTUNG, Johan. "A Structural Theory of Imperialism." *Journal of Peace Research* 8, no. 2 (1971): 81-117.
- GOSTENTSCHNIGG, Kurt. *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär*. Wiesbaden: Springer VS, 2018.
- GURAKUQI, Romeo. "Shqipëria dhe Shkodra në periudhën gusht 1914 – shkurt 1916." *Kuvendi*, nr. 10, 2018.
- GUY, Nicola. *The Birth of Albania*. London: I.B. Tauris, 2012.
- HERTNER, Peter. "Grassmachtrivalität und Kooperation im Adriaum. Italien, Österreich-Ungarn und das Projekt einer albanischen Staatsbank, 1913/14". *Quellen und Forschungen aus Italienischen Archiven und Bibliotheken* 85 (2005): 272-317.
- Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I, drejtues dhe redaktor shkencor Beqir Meta, grup autorësh, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet albanologjike, 2017.
- HOBSBAWM, Eric & Terence Ranger, eds. *The Invention of Tradition*. Cambridge: Cambridge University Press, 1983.
- INGLEHART, Ronald, & Christian Welzel. *Modernization, Cultural Change, and Democracy*. Cambridge: Cambridge University Press, 2005.
- KADRIA, Sali. *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*. ASA/Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2020.
- KERA, Gentiana & Enriketa Pandelejmoni. "Austrian-Hungarian Military Administration in Albania during World War I." *Foreign Policy Review* 15, no. 1 (2022).
- MARTELLI, Fabio. *Capire 'Albania*. Bologna: Il Mulino/Alfa Tape, 1998.
- NASKA, Kaliopi. "Politika ekonomike e Qeverisë së Vlorës (1912-1914)." *Studime historike*, 1 (1988): 77-89.
- NASKA, Kaliopi. *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve "Adriatiku" dhe "Gazet' e Korçës"*. Tiranë: Kristalina-KH, 2017.
- PREBISCH, Raúl. *The Economic Development of Latin America and Its Principal Problems*. United Nations: Economic Commission for Latin America (ECLA), 1950.

- REITER, Bernd (ed.) *The Dialectics of Citizenship: Exploring Privilege, Exclusion, and Racialization*. East Lansing: Michigan State University Press, 2013.
- ROSELLI, Alessandro. *Italy and Albania: Financial Relations in the Fascist Period*. London–New York: I.B. Tauris & Co. Ltd, 2006.
- SHKOZA, Haxhi. *Financat e Shqipnis (1839-1934)*. Tiranë: Nikaj, 1935.
- TILLY, Charles. *Coercion, Capital, and European States, AD 990-1990*. Cambridge, Mass.: Basil Blackwell, 1990.
- TILLY, Charles. “Reflection on the History of the European State-Making.” In *THE FORMATION OF NATIONAL STATES IN WESTERN EUROPE*, ED. CHARLES Tilly, 3-83. Princeton: Princeton University Press, 1975.
- ZAMAGNI, Vera. *The Economic History of Europe Since 1700*. Newcastle upon Tyne: Agenda Publishing, 2017.

Shtypi:

Përlindja e Shqipniës, Vlonë, 1913

Shqypnia e Re, Shkodër, 1918

PROF. DR. LEDIA DUSHKU

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

ledia_dushku@yahoo.com

S u m m a r y

The article explores Albania’s earliest efforts to establish a national banking system between 1913 and 1918; a period marked by fragile statehood, foreign rivalry, and contested sovereignty. Its central focus is the creation of the National Bank of Albania, initiated by the Provisional Government of Vlorë in 1913. For Albanian elites, the bank embodied aspirations for state-building and modernization. Yet the concession signed with Austria-Hungary and Italy exposed the limits of Albanian autonomy: while nominally “national,” the bank was in practice driven by

foreign capital and designed to secure external control over state finances.

The study traces how this project unfolded amid Albania's unstable political landscape and the broader dynamics of international competition. The outbreak of World War I turned Albania into a battleground, fragmenting its territory and integrating its economy into multiple foreign monetary systems: the Austro-Hungarian crown, the Italian lira, and the French franc. This division obstructed the formation of a unified financial market. Even symbolic gestures, like the 1917 Korça banknotes, reflected both the will for sovereignty and the persistence of foreign supervision.

Drawing on theories of state-building (Tilly), dependency (Prebisch, Frank), and structural imperialism (Galtung), the article argues that Albania's early banking experience exemplifies dependent modernization: institutions were created, but on externally imposed terms. The failure of the 1913 bank project, and the continuation of financial dependency under Italian control in the 1920s, highlights the challenges of building core institutions in peripheral contexts. Ultimately, Albania's early banking history serves as a case study of how peripheries navigate the disjuncture between sovereign ambition and structural constraint.

Keywords: State formation, National Bank of Albania, structural dependency, sovereignty, peripheral modernization; World War I.

